

# Raport përmbledhës

**Takimi i Grupit të Dialogut – 27  
Janar 2014**

**me**

**Përfaqësues të Komunitetit dhe  
Kompanisë Bankers Petroleum  
Albania Ltd. (BPAL)**

**Përgatitur nga**

Kate Kopischke, Rasim Gjoka, Merita Bala  
Moderatorë/Lehtësues të Avokatit të Trajtimit të  
Ankesave (CAO)

---

## **Vendi dhe koha e takimit**

Hotel Fieri

E hënë, 27 Janar 2014

Ora 12:30 - 15:30

## **Pjesëmarrës\***

- Përfaqësues të komunave Zharrëz, Kuman, Mbrostar
- Përfaqësues të Bashkisë Roskovec
- Përfaqësues të Departamentit të Marrëdhënieve me Komunitetin, Bankers Petroleum
- Përfaqësues nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, Bankers Petroleum (folëse e ftuar)
- Përfaqësues i Kompanisë së Sigurisë të kontraktuar nga Bankers Petroleum (folës i ftuar)
- Përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI) (folës i ftuar)
- Përfaqësues i Albpetrol-it (folës i ftuar)

## **Qëllimet e takimit**

1. Organizimi i takimit të parë me të gjithë anëtarët e Grupit të Dialogut të moderuar nga CAO
2. Rishikimi i vendimeve të marra në takimet e mëparshme dhe vazhdimi i përgatitjes së “Termave të Referencës” për Grupin e Dialogut
3. Njohja me procesin e instalimit të sizmografëve
4. Prezantimi dhe diskutimi rreth: Punësimit në Bankers Petroleum

## **Përmbledhje e temave dhe diskutimeve**

1. Informacion i përditësuar për Projektin e Instalimit të Sizmografëve
2. Struktura e Grupit të Dialogut dhe rregullat e funksionimit (“Termat e Referencës”)
3. Punësimi dhe praktikat e punësimit të BPAL-it (prezantime nga folës të ftuar)

**Pjesa e 4-ët e këtij raporti** përfshin një “Përmbledhje të Përfundimeve” për takimin e datës 27 janar si dhe “Propozime për hapat e mëtejshëm të Grupit të Dialogut”. CAO kërkon reflektimin e çdo pjesëmarrësi të Grupit të Dialogut për hapat e mëtejshëm të propozuar, brenda 30 ditësh nga marrja e këtij Raporti Përmbledhës.

### **1. Informacion për Projektin e Instalimit të Sizmografëve**

Përfaqësuesi nga MEI, i ftuar për të prezantuar, bëri një përmbledhje të shkurtër rreth zhvillimeve të fundit në lidhje me instalimin e dy sizmografëve në

afërsi të komuniteteve të prekura. Ai u shpreh se ka pasur mirëkuptim midis Albpetrol-it dhe BPAL-it për caktimin e vendeve ku do të instalohen dy sizmografët: njëri në Zharrëz dhe njëri në Sheqishtë. Ai raporti gjithashtu se Albpetrol-i kishte hartuar së fundmi një marrëveshje dhe ia kishte dërguar BPAL-it për rishikim.

Një nga përfaqësuesit e BPAL-it informoi gjithashtu të pranishmit për vendosjen e sizmografëve. Sipas tij, megjithëse, marrëveshja nuk ishte firmosur ende, Bankers kishte vazhduar punën në terren për instalimin, duke bërë shpimet në vendet ku do të vendosen sizmografët dhe se inxhinieri i kompanisë, ku janë marrë sizmografët ("Nanometrics"), do të vinte më datë 28 janar për t'i vënë sizmografët në punë.

## **2. Struktura e Grupit të Dialogut dhe Parimet e Funkcionimit**

Në takimin e mëparshëm të datës 16 dhjetor 2013, disa anëtarë të komunitetit dhe përfaqësues të BPAL-it ranë dakord paraprakisht për:

- 1) Tri çështjet kryesore/prioritetet ku do të fokusohet Grupi i Dialogut: punësimi, investimet dhe gjendja mjedisore;
- 2) Komunitetet që do të përfaqësohen/një listë të emrave që do të jenë pjesë e grupit të dialogut;
- 3) Organizimin e takimeve mujore të Grupit të Dialogut, të drejtuara nga CAO.

Pjesëmarrësit në takimin e datës 16 dhjetor diskutuan gjithashtu shkurtimisht për "Termet e Referencës" të grupit, ku të qartësoheshin qëllimet, struktura/përbërja dhe rregullat e funksionimit të Grupit të Dialogut.

Meqë takimi i datës 27 janar 2014 përfshinte një grup më të gjerë pjesëmarrësish, dhe ishte ideuar si fillimi "zyrtar" i punës së Grupit të Dialogut", CAO kishte përgatitur paraprakisht një draft të "termave të referencës" për t'u shqyrtuar nga grupi i gjerë dhe u shpërndanë për diskutim.

Dokumenti i propozuar përfshinte qëllimin, anëtarësinë, mënyrën e vendimmarrjes, dhe komunikimin me komunitetin si dhe parime të tjera organizative - për t'u vendosur bashkërisht nga grupi. Për shkak të kohës së kufizuar të takimit të datës 27 janar, pjesëmarrësit nuk patën mundësi të diskutonin draftin e plotë të përgatitur nga CAO. Megjithatë, diskutimi rreth këtyre termave të referencës u fokusua në çështjet e mëposhtme:

- Qëllimi i Grupit të Dialogut
- Anëtarësia e Grupit të Dialogut / përbërja
- Roli i medias.

### ***Qëllimi i Grupit të Dialogut***

Të gjithë pjesëmarrësit ishin dakord që dialogu është një mënyrë konstruktive për të adresuar shqetësimet e komunitetit dhe për të diskutuar për mundësi të reja. Të dyja palët, në parim, ishin dakord të vazhdonin dialogun, dhe se përmes këtij dialogu të arrihen rezultate konkrete.

Nga një përfaqësuesit e komunitetit u shpreh se vazhdimi i dialogut dhe dobishmëria e tij varën nga zgjidhja e problemit kryesor të ngritur në ankesën drejtuar CAO-s: shkaku i tërmeteve.

Një përfaqësues i BPAL-it u shpreh se Grupi i Dialogut duhet të fokusohet jo vetëm te ankesat, por dhe se si të identifikohen dhe krijohen bashkërisht mundësi të reja.

Anëtarët e komunitetit u shprehën se procesi i dialogut do të jetë i suksesshëm nëse adreson interesat e tyre parësore për punësim dhe përmirëson gjendjen sociale dhe mjedisore në komunitetet e tyre.

### ***Anëtarësia e Grupit të Dialogut / përbërja***

Në lidhje me anëtarësinë dhe përfaqësimin në Grupin e Dialogut, pjesëmarrësit shprehën mendime të ndryshme:

*Këndvështrimi i Bankers Petroleum:* Përfaqësuesit e BPAL-it u shprehën se e vlerësojnë diversitetin e grupit (komunitet, pushtet vendor, OJQ, etj). Sidoqoftë, ata janë të mendimit se në Grupin e Dialogut duhet të ketë përfaqësim dhe nga komunitetet/fshatrat e tjera ku operon BPAL-it. Në këtë mënyrë, çdo komunitet i afektuar do të ketë mundësi të ngrejë zërin e tyre, të jenë pjesë e procesit, dhe kështu do të përfaqësohen këndvështrimet e të gjitha komuniteteve. BPAL sugjeroi gjithashtu dhe një diversitet më të madh të grupeve të përfaqësuara, si të rinjtë, më shumë gra, punonjës të

shëndetësisë, etj. Kjo ide u përkrah dhe nga përfaqësuesja e OJQ-së që merrte pjesë në takim.

*Këndvështrimi i Komunitetit:* Përfaqësuesit e Zharrëzës u shprehën se ata marrin pjesë në Grupin e Dialogut si përfaqësues 'legjitimë' të komunitetit të tyre, dhe se janë caktuar nga Komiteti i Protestave të ngritur në dhjetor 2013.

Gjithashtu dhe përfaqësuesit nga Kumani u shprehën se janë caktuar nga komuniteti i tyre.

Përfaqësuesi nga Mbrostari u shpreh se ishte i ftuar të merrte pjesë në takim, por nuk përfaqësonte këshillin e komunës.

Disa pjesëmarrës shprehën shqetësimin e tyre për rritjen e numrit të pjesëmarrësve në grupit, pasi më shumë njerëz do ta bënin vendimmarrjen më të vështirë.

### ***Roli i medias***

Përfaqësuesit e komunitetit ngritën shqetësimin se pse nuk ishte ftuar media në takim. Sipas këndvështrimit të tyre, përfshirja e medias do të ndihmonte në informimin e komunitetit më të gjerë për punën e Grupit të Dialogut.

Grupi i CAO-s shpjegoi për pjesëmarrësit se një nga parimet kryesore të suksesit të një grupi dialogu është që të dyja palët duhet të diskutojnë dhe të bien dakord paraprakisht për rolin e medias, për të shmangur në këtë mënyrë 'përdorimin e medias' për të tejzgjatur ose

përshkallëzuar konfliktin. Për shembull: duhet rënë dakord paraprakisht se kush do ta ftojë median në takim? Çfarë informacioni apo mesazhi të përbashkët do të ndajë Grupi i Dialogut me median? Çfarë ndodh nëse mediat kanë paragjykimet e tyre dhe nuk e raportojnë me saktësi se çfarë ndodh në Grupin e Dialogut?

Pjesëmarrësit nuk e përfunduan këtë diskutim, as nuk u arritit ndonjë marrëveshje për rolin e medias në Grupin e Dialogut.

### **3. Punësimi dhe praktikat e punësimit të BPAL**

Në takimin e [mëparshëm] të datës 16 dhjetor 2013, anëtarët e komunitetit identifikuan punësimin si çështjen kryesore për të diskutuar në takimin e parë 'zyrtar' të Grupit të Dialogut. Në përgatitjet për takimin e datës 27 janar 2014, përfaqësuesit e Bankers në Grupin e Dialogut ftuan menaxheren e Burimeve Njerëzore të kompanisë për të bërë një prezantim të shkurtër për praktikat e punësimit të BPAL-it.

Menaxherja e Burimeve Njerëzore paraqiti disa statistika për numrin e të punësuarve nga BPAL dhe nën-kontraktorët e saj. Ajo theksoi se pjesa më e madhe e punonjësve është punësuar nga nën-kontraktorët, sesa vetë kompania.

Më pas u ftuan përfaqësuesit e një kompanie të nënkontraktuar, Kompanisë së Sigurisë Titan, për të prezantuar politikat e tyre të punësimit. Ata përshkruan politikën e tyre të përgjithshme për përzgjedhjen e aplikantëve të kualifikuar për pozicionet e

punonjësve të sigurisë, dhe u shprehën se plotësimi i kriterëve strikte të përcaktuara përbënte kusht për punësimin në kompaninë e tyre. Një përfaqësues i Kompanisë Titan Security i ftoi pjesëmarrësit e Grupit të Dialogut që ishin të interesuar të shkonin në zyrën e tij nëse dëshironin të merrnin më shumë informacion.

Përfaqësuesit e komunitetit kontestuan vërtetësinë e informacionit të dhënë nga BPAL. Ata shprehën bindjen e tyre se më shumë se 1/2 e njerëzve të punësuar nga BPAL nuk janë nga komunitetet e zonës. Përveç kësaj ata besojnë se ka mungesë transparence në praktikat e punësimit dhe theksuan se do të përgatisin propozime konkrete në lidhje me punësimin dhe do t'ia paraqesin kompanisë Bankers Petroleum.

Përfaqësuesit e BPAL-it u shprehën se ishin të hapur për të rishikuar dhe diskutuar çdo propozim konstruktiv.

Përfaqësuesit e kompanisë shpjeguan se ajo ka të punësuar vetëm 300 persona – një numër shumë më i vogël sesa numri i banorëve që kërkojnë punësim. Për këtë arsye, BPAL ka ndërmarrë një numër programesh për të zhvilluar aktivitete të tjera për të gjeneruar të ardhura. Për shembull, Programi i Trajnimit Profesional që i ndihmon banorët të zhvillojnë aftësitë e tyre në sektorë të ndryshëm. "Programi i Mbështetjes Bujqësore" ofron trajnime dhe këshillime për orientimin e bujqësisë drejt biznesit. Përfaqësues të kompanisë thanë se ata po organizojnë takime me të gjithë komunitetet e zonës për të informuar dhe përfshirë njerëzit në këto dhe programe të tjera, duke shtuar se ky Grup i Dialogut paraqet një mundësi për

të gjeneruar ide të tjera dhe për të ndarë informacion për këto nisma.

#### **4. Përfundime dhe hapat e mëtejshëm të propozuar**

Në mbyllje të takimit të datës 27 Janar, pjesëmarrësit shprehën opinione të ndryshme në lidhje me procesin e dialogut të moderuar nga CAO. Disa anëtarë të komunitetit u shprehën se nuk e shikojnë të arsyeshme të vazhdojnë dialogun, pasi nuk e mendonin se dialogu do të kishte një impakt të menjëhershëm në angazhimin e BPAL-it për punësimin. Të tjerë përkrahën idenë e një Grupi Dialogu, por ishin të mendimit se, që procesi të ishte i suksesshëm, duhet të përfaqësoheshin të gjitha komunitetet e zonave ku operon BPAL-i. Kishte dhe pjesëmarrës që shprehën interes për vazhdimin e dialogut siç ishte kërkuar fillimisht nga banorët e Zharrëzës.

Për disa anëtarë të komunitetit që ishin të pranishëm në takimin e datës 27 janar, ishte hera e parë që njiheshin me ankesën e bërë te CAO dhe me procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes siç ishte rënë dakord nga përfaqësuesit e Zharrëzës dhe BPAL-it pas vlerësimit të situatës të bërë nga CAO në maj 2013. Gjithashtu për ta ishte hera e parë që njiheshin me çështjet specifike që ishin identifikuar më parë si temat kryesore që do të trajtonte Grupi i Dialogut. Kështu, jo të gjithë pjesëmarrësit në takimin e datës 27 janar ishin të qartë, apo kishin rënë dakord me parë për qëllimin, objektivat dhe

rezultatet e pritshme të procesit të dialogut.

Nga këndvështrimi i CAO-s, megjithëse përfaqësuesit e komuniteteve të prekura dhe BPAL-it kanë interesa të përbashkëta, ekzistojnë ende paqartësi dhe ka mungesë konsensusi për qëllimin dhe përfitimet e mundshme nga një procesi afatgjatë i dialogut. Para se të vazhdohet me Grupin e Dialogut të propozuar nga CAO, dhe siç ishte rënë dakord në Dhjetor 2013, është e rëndësishme që të gjithë pjesëmarrësit e Grupit të kenë një vizion të përbashkët se si një proces i tillë mund të ndihmojë për të identifikuar dhe arritur qëllimet e tyre të përbashkëta.

Gjatë muajit në vazhdim, grupi i CAO-s do të bëjë takime të veçanta me grupe të komunitetit dhe përfaqësues të BPAL-it për të marrë mendimet e tyre dhe gjithashtu propozime për vazhdimin e procesit të dialogut. Këto takime të veçanta do të fokusohen në: (1) idetë e njerëzve nëse ata mund të përfitojnë nga dialogu kompani-komuniteti dhe si, (2) çështjet kryesore që ata mendojnë se mund të adresohen efektivisht përmes dialogut, (3) propozimet e tyre ose rezultatet e pritshme për ta nga një proces i tillë, dhe (4) standardet specifike ose 'rregullat bazë' që ata mendojnë se duhet të respektohen që dialogu të jetë i suksesshëm.

Në përfundim të këtyre takimeve të veçanta me palët e përfshira, CAO do të përgatisë një raport përmbledhës për vullnetin e palëve dhe idetë për vazhdimin e procesit të dialogut.

# # #